



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti**  
**Mbledhja nr. 141/2024**  
**Prishtinë, më 19.9.2024, në orën 10:15**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Abelard Tahiri, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

**Mungoi:** Armend Muja, anëtar.

**Pjesëmarrës tjerë:** Sami Gashi dhe Salih Hoxha – GP LVV, Fjollë Haziri – KDI, Festim Bytyçi – GP AAK dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 5 dhe 9.7.2024;**
- 3. Miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për sesionin pranveror 2024;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për lexim të dytë për Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit;**
- 5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për lexim të dytë për Projektligjin nr.08/L-295 për Kripto-asetet;**
- 6. Rishpallja e konkursit për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU”;**
- 7. Formimi i panelit për zhvillimin e procesit të intervistimit për zgjedhjen “Drejtor të Bordit të NP KOSTT – tri pozita”;**
- 8. Të ndryshme.**

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 5 dhe 9.7.2024;**

*Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura me datë 5 dhe 9.7.2024, u miratuan pa vërejtje.*

## **3. Miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për sesionin pranveror 2024;**

**Kryetari**, tha se gjatë sesionit pranveror të këtij viti, ka zhvilluar aktivitetet e tij në bazë të planit të tij të punës, ku gjatë kësaj periudhe, në tërësi, realizoi 67 aktivitete, me një mesatare prej më shumë se 9 aktiviteteve në muaj. Këto aktivitete, Komisioni i ka realizuar nëpërmjet 18 mbledhjeve të rregullta, 19 mbledhjeve të grupeve të punës, 5 dëgjimeve publike, 5 takimeve zyrtare, 16 vizitave zyrtare në institucionet përkatëse, me qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre dhe aktiviteteve tjera.

*Pas debatit Komisioni njëzëri miratoi Raportin e Punës për sesionin pranveror të këtij viti (2024).*

## **4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për lexim të dytë për Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit;**

**Kryetari**, tha se në pajtim me neni 76 paragrafi 9 i Rregullores së Kuvendit, ky projektligj i ka kryer të gjitha procedurat në mes dy leximeve, andaj, sot e procedojmë tutje për lexim të dytë në Kuvend.

*Komisioni njëzëri nxori këtë:*

*Përfundim*

*Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij me amendamente.*

## **5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për lexim të dytë për Projektligjin nr.08/L-295 për Kripto-asetet**

**Kryetari**, tha se në pajtim me neni 76 paragrafi 9 i Rregullores së Kuvendit, ky projektligj i ka kryer të gjitha procedurat në mes dy leximeve, andaj, sot e procedojmë tutje për lexim të dytë në Kuvend.

*Komisioni njëzëri nxori këtë:*

*Përfundim*

*Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin NR.08/L-295 për kripto-asetet dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij me amendamente.*

## **6. Rishpallja e konkursit për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU”**

**Kryetari**, tha se në bazë të nenit 29 dhe 110 të Rregullores së Kuvendit, dhe në përputhje me nenin 42 të Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, jemi njoftuar nga Personeli i Kuvendit me datë 16.7.2024, se nuk ka aplikuar asnjë kandidat për pozitën “Kryesues i Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU” andaj, duhet ta rishpallim konkursin për këtë pozitë sipas ligjit.

*Komisioni njëzëri nxori këtë:*

### **V E N D I M**

- 1. Të rishpallet konkursi për zgjedhjen e drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU;*
- 2. Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit në bazë të Ligjit;*
- 3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.*

## **7. Formimi i panelit për zhvillimin e procesit të intervistimit për zgjedhjen “Drejtor të Bordit të NP KOSTT – tri pozita”**

**Kryetari**, tha se jeni të informuar me datë 16.7.2024, nga Qeveria janë proceduar dosjet lidhur me plotësimin e tri pozitave të lira në NP KOSTT – ku kanë aplikuar 24 kandidatë. Sipas praktikës tanimë të ndërtuar, propozoj që tërë Komisioni të jetë në Panel, normalisht kush dëshiron të tërhiqet vullnetarisht mund të deklarohet sot, por nëse mungon gjatë procesit të intervistimit automatikisht përjashtohet nga Paneli.

*Komisioni njëzëri nxori këtë:*

### **V E N D I M**

- 1. Formohet Paneli për plotësimin e Bordit të NP KOSTT – tri pozita;*
- 2. Paneli do të këtë tërë Komisionin në përbërje;*
- 3. Deputeti i cili mungon në procesin e intervistimit ose gjatë procesit të intervistimit tërhiqet nga Paneli, konsiderohet sikur të mos kishte marrë pjesë fare në këtë proces;*
- 4. Paneli kryen procesin e intervistimit të kandidatëve dhe i paraqet Komisionit raport më shkrim;*
- 5. Shpenzimet e krijuara nga aktiviteti i Panelit mbulohen nga buxheti i Komisionit.*

## **8. Të ndryshme.**

- a) **Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor për vitin 2024**, kryetari tha, se e autorizojmë administratën e Komisionit që ta përgatisë një draft të planit dhe në mbledhjen e radhës e shqyrtojmë.

- b) **Njoftim nga Autoriteti i Konkurrencës**, kryetari tha se lidhur me moshën e një anëtare të bordit në AKRK, kemi pranuar një letër nga kryesuesja e bordit, kërkoj nga administrata e Komisionit që ta përgatisë një shkresë lidhur me këtë çështje dhe e njofton Komisionin.
- c) **Shkresa nga ARRU-ja**, në lidhje me konfliktin e ligjit tani të miratuar për reformën në procedurën administrative, i cili sipas tyre është në konflikt me ligjin në fuqi të shërbimeve të ujit, kryetari tha, se të kërkohej nga Departamenti ligjor i Kuvendit që t’na njoftojë lidhur me këtë shkresë.
- d) **Kërkesë nga gazetari Visar Duriqi**, në lidhje me dënimin e kryetarit aktual të Bordit të AKP-së, Mentor Hyseni nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Kryetari tha, se së pari të kërkojmë nga pala në fjalë t’na njoftojë në lidhje me këto pretendime e mandej ta njoftojmë gazetarin.
- e) **Kërkesë nga një person fizik (Gojart Kllokoqi)**, ku ankohet në KPMM-në, në lidhje me licencat e lëshuara në pronën e tij. Kryetari tha, se sot do ta takoj palën dhe në mbledhjen e radhës ju njoftoj për këtë çështje.
- f) **Në mbledhjen e radhës**, kryetari tha se do vazhdojmë me shqyrtimin e raportit vjetor të NP KOSTT-it për vitin 2023, të filluar me datë 5.7.2004, si dhe me raportin vjetor të KPMM-së për vitin 2023.

**Mbledhja përfundoi në orën 10:30.**

**E përgatiti: Staf mbështetës i Komisionit.**

**Ferat Shala,**

-----  
**Kryetar i Komisionit**